

VENDIM

Nr. 555, datë 11.8.2011

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË PERSONELIT MJEKËSOR, TË PUNONJËSVE TË TJERË ME ARSIM TË LARTË DHE TË PUNONJËSVE TË PERSONELIT TEKNIK TË SHKENCAVE MJEKËSORE, NË SISTEMIN E MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR SHËNDETËSINË, NË NJËSINË MJEKËSORE USHTARAKE PRANË SPITALIT UNIVERSITAR TË TRAUMËS, NË STRUKTURAT E TJERA TË FORCAVE TË ARMATOSURA DHE NË INSTITUCIONET E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE DHE SPITALIN PËRKATËS.

(Ndryshuar me VKM nr. 527, datë 16.8.2012; nr. 1035, datë 27.11.2013; nr. 241, datë 18.3.2015; nr. 527, datë 18.6.2015; nr. 911, datë 21.12.2016; nr. 188, datë 15.3.2017; nr. 555, datë 29.9.2018; nr. 243, datë 19.4.2019, nr. 564, datë 16.7.2020; nr. 1076, datë 24.12.2020)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr.10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011” me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen:

- a) personeli mjekësor dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë të sistemit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë;
- b) personeli teknik i shkencave mjekësore në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë;
- c) personeli mjekësor, punonjësit e tjerë civilë me arsim të lartë dhe personeli teknik i shkencave mjekësore, në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës;
- ç) personeli mjekësor ushtarak në strukturat e Forcave të Armatosura, vetëm për efekt të kryerjes së shërbimeve (roje, gatishmëri, urgjencë);
- d) personeli mjekësor civil dhe personeli teknik i shkencave mjekësore, civilë, në strukturat e Forcave të Armatosura të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes;
- dh) punonjësit e Njesisë së Helikopterëve të Transportit Mjekësor të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes;
- e) personeli mjekësor dhe personeli teknik i shkencave mjekësore në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkatës.

2. Struktura dhe nivelet e pagave për:

- a) punonjësit e administrimit të përgjithshëm nga “specialist” deri në “titullar institucioni”, në strukturat shëndetësore universitare, në spitalet rajonale, në spitalet psikiatrike dhe në spitalet bashkiake, janë sipas lidhjes nr. 1/ AP, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;
- b) personelin mjekësor në strukturat shëndetësore universitare dhe në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, janë sipas lidhjes nr. 1, kreu 1.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;
- c) nëpunësit/punonjësit e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, janë sipas lidhjes nr. 1, kreu 1.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;
- ç) personelin mjekësor në Qendrën Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët, janë sipas lidhjes nr. 1, kreu 1.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;
- d) personelin mjekësor në spitalet psikiatrike, rajonale dhe bashkiake, janë sipas lidhjes nr. 1, kreu 1.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

dh) personelin mjekësor dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë në Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, janë sipas lidhjes nr. 1, kreu 1.5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

e) personelin mjekësor dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë në Qendrën e Shërbimeve Mjekësore, janë sipas lidhjes nr. 1, kreu 1.6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

ë) personelin mjekësor dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë në Qendrën e Inxhinierisë Biomjekësore, janë sipas lidhjes nr. 1, kreu 1.7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

f) personelin mjekësor dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë në Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, janë sipas lidhjes nr. 1, kreu 1.8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

g) punonjësit me arsim të lartë në Qendrën Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore dhe Qendrën Kombëtare të Edukimit në Vazhdim, janë sipas lidhjes nr. 1, kreu 1.9, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

gj) punonjësit e Njësive të Helikopterëve të Transportit Mjekësor të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes, janë sipas lidhjes nr. 1, kreu 1.10, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

h) personelin mjekësor dhe personelin teknik të shkencave mjekësore në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkatës, janë sipas lidhjes nr. 8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

i) personelin mjekësor civil, në strukturat e Forcave të Armatosura të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes, janë sipas lidhjes nr. 9, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

j) personelin teknik të shkencave mjekësore të sistemit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, personelin teknik të shkencave mjekësore, civile, të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe personelin teknik të shkencave mjekësore në Njësine Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, janë sipas lidhjes nr. 2 me kërër të përkatës, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2.1. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e personelit me tituj akademikë, që janë të punësuar me kohë të plotë në Institutin e Shëndetit Publik (ISHP), janë sipas lidhjes nr. 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2.2. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e tjerë me arsim të lartë në ISHP, janë sipas lidhjes nr. 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2.3. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit laborantë në ISHP, janë sipas lidhjes nr. 7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Paga e grupit (kolona 1 e lidhjes nr. 1 me kërër të përkatës, kolona 1 e lidhjes nr. 2 me kërër të përkatës, kolona 3 e lidhjes nr. 6, kolona 1 e lidhjes nr. 7, kolona 1 e lidhjes nr. 8 dhe kolona 1 e lidhjes nr. 9), përcaktohet sipas lidhjeve përkatëse të këtij vendimi dhe vlera e saj është sipas lidhjes nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3.1. Shfuqizuar.

4. Shtesa për vjetërsi në punë, kolona 2, e lidhjeve përkatëse, jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

4.1 Punonjësit e personelit me tituj akademikë të punësuar me kohë të plotë në ISHP, të cilët trajtohen në pagë sipas lidhjes nr. 5, përfitojnë shtesë për vjetërsi në punë, në masën 0,5 % për çdo vit pune, por jo më shumë se 15 vjet.

5. Shtesa për kualifikim, kolona 3 e lidhjeve përkatëse është 0.

6. Shtesa për pozicion është sipas kolonës 4 të lidhjes nr.1 dhe të lidhjes nr.2 si dhe të lidhjes nr.6, lidhjes nr.7, lidhjes nr. 8 dhe lidhjes nr. 9.

7. Shtesa për kushte pune është sipas kolonës 5 të lidhjes nr.1 dhe të lidhjes nr.2 si dhe të lidhjes nr.7, lidhjes nr. 5, lidhjes nr. 6 dhe lidhjes nr. 8.

8. Shfuqizuar.

9. Mjekët dhe punonjësit e infermieristikës, që punojnë larg vendbanimit, marrin shpërblim mujor në masën si më poshtë vijon:

9/1 Për mjekët:

a) kur punojnë në rrethet: Pukë, Tropojë, Kukës, Has, Malësi e Madhe, Dibër, Bulqizë, 4

500 lekë në muaj;

b) kur punojnë në rrethet: Mat, Mirditë, Gramsh, Librazhd, 3 800 lekë në muaj.

9/2 Për punonjësit e personelit teknik të shkencave mjekësore:

a) kur punojnë brenda rrethit të tyre, por larg vendbanimit dhe kthehen brenda ditës, 3 000 lekë në muaj.

b) kur nuk kthehen në vendbanim brenda ditës, 4 000 lekë në muaj.

10. Për punonjësit e personelit mjekësor që nuk janë efektivë me kohë të plotë në qendrat spitalore e shëndetësore të sistemit të Ministrisë së Shëndetësisë e të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes, për shërbimin që kryejnë në këto qendra, kontrahohen me orë pune të caktuara. Vlera e pagesës së një ore pune të kontraktuar është e njëjtë me vlerën orare të pozicionit të punës, për të cilin është kontraktuar.

10/1 Trajtimi financiar i punonjësve mjekësorë të korpusit akademik të Fakultetit të Mjekësisë, të Universitetit të Tiranës që shërbejnë në institucionet shëndetësore, për shërbimin që ofrojnë pranë këtyre strukturave, është si vijon:

	Kualifikimi/Grada/Titulli shkencor	Trajtimi financiar (lekë në muaj)
1	Shef shërbimi Profesor,	75 000
2	Shef shërbimi Profesor i asociuar	70 000
3	Shef shërbimi Doktor i shkencave	67 000

10/2 Trajtimi financiar i punonjësve mjekësorë të korpusit akademik të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Tiranës që shërbejnë pranë Institutit të Shëndetit Publik, për shërbimin që ofrojnë pranë këtyre strukturave, është 70 000 lekë në muaj.

11. Mjekët e sistemit të Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe mjekët civilë të strukturave të Forcave të Armatosura, të cilët kryejnë specializimin në qendrat spitalore universitare, gjatë kohës së specializimit, të paguhet në masën 80 për qind të pagës së mjekut të fushës në të cilën kryhet specializimi.

12. Për kryerjen e shërbimit të rojës, të gatishmërisë dhe urgjencës, të sistemit të Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe mjekëve, civilë e ushtarakë, të strukturave të Forcave të Armatosura u jepet shpërblim si më poshtë vijon:

12/1 Për mjekët:

a) Për çdo shërbim rojë 24 orë pa ndërprerje u jepet një shpërblim:

Në qendrat spitalore universitare:	Mjek rojë i parë	Mjek rojë i dytë
Për ditët e zakonshme	6 000 lekë	5 600 lekë
Për ditët e shtuna	7 000 lekë	6 400 lekë
Për ditët e diela e festat	8 000 lekë	7 600 lekë

Në institucionet e tjera:	Mjek rojë i parë	Mjek rojë i dytë
Për ditët e zakonshme	5 600 lekë	5 200 lekë
Për ditët e shtuna	6 000 lekë	5 600 lekë
Për ditët e diela e festat	7 000 lekë	6 600 lekë

b) Për shërbimin e urgjencës së rrethit, që është organizuar dhe funksionon si i tillë, për kohën që kryejnë shërbimin e urgjencës u jepet një shpërblim në masën:

	Në ditët e zakonshme	Të shtuna	Të diela dhe festa
- për sistemin 24 orë	2 300 lekë	2 400 lekë	2 700 lekë
- për sistemin 16 orë	2 000 lekë	2 300 lekë	2 400 lekë

- për sistemin 12 orë	1 800 lekë	2 000 lekë	2 300 lekë
-----------------------	------------	------------	------------

c) Kur thirren për raste urgjence, pasdite ose natën, nga mjeku i rojës së spitalit, për veprime diagnostikuese apo mjekuese, shpërblehen në masën 600 lekë deri në 1 000 lekë, në varësi të procedurës mjekësore që kryejnë. Këto shpërblime nuk mund të jenë më shumë se 20 për qind e pagës mujore për çdo muaj.

12/2 Për punonjësit e infermieristikës:

a) Për punën e kryer nga ora 19:00 deri në 22:00 përfitojnë shtesë mbi pagë 120 lekë për çdo ditë, ndërsa për punën e kryer në intervalin 22:00 dhe 6:00 përfitojnë shtesë mbi pagë 500 lekë për çdo ditë.

b) Për shërbimin e urgjencës së rrethit, që është organizuar dhe funksionon si i tillë, për kohën që kryejnë shërbimin e urgjencës, u jepet një shtesë, si më poshtë vijon:

Në ditë të zakonshme të shtuna	të diela	dhe festa:
- për sistemin 24 orë 1700 lekë	2100 lekë	2500 lekë;
- për sistemin 16 orë 1400 lekë	1700 lekë	2200 lekë;
- për sistemin 12 orë 1100 lekë	1400 lekë	1700 lekë.

c) Për rastet kur, me kërkesë të institucionit dhe miratim të Ministrisë së Shëndetësisë e Ministrisë së Mbrojtjes, laborantët e spitaleve kryejnë shërbim 24 orë, u jepet një shtesë, si më poshtë vijon:

- për ditë të zakonshme	1 300 lekë
- për ditët e shtuna	1 600 lekë
- për ditët e diela dhe festa	2 100 lekë

ç) Për raste të veçanta, kur mjeku i rojës e sheh të domosdoshme thirrjen e personelit të infermieristikës për kryerjen e ekzaminimit apo të mjekimit, ky personel shpërblehet në masën 300 lekë deri në 750 lekë, për çdo rast. Këto shpërblime nuk mund të jenë më shumë se 20% e pagës mujore për çdo muaj.

12/3 Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Mbrojtjes përcaktojnë kriteret dhe rregullat për dhënien e shpërblimit, sipas pikave 12/1 dhe 12/2 të këtij vendimi.

12/4. Shpërblimi i punonjësve të personelit të Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimi, pjesë e Institutit të Shëndetit Publik, është në masën 10 000 lekë në muaj.

12/5. Mjekët e spitaleve në shërbimin e urgjencës, shërbimin e reanimacionit, shërbimin e hemodinamikës, në njësinë e aksidenteve cerebrale, si dhe mjekët neonatë, përfitojnë një shtesë për natyrë të veçantë pune në masën 18 000 (tetëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj.

12/6. Infermierët dhe laborantët e spitaleve në shërbimin e urgjencës, shërbimin e reanimacionit, shërbimin e hemodinamikës dhe në njësinë e aksidenteve cerebrale përfitojnë një shtesë për natyrë të veçantë pune në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në muaj.

12/7. Mjekët, të cilët në zbatim të sistemit të referimit dërgohen për konsulta dhe ndërhyrje kirurgjikale në spitale të tjera, përfitojnë për çdo ditë shërbimi një shtesë në pagë, si më poshtë vijon:

a) mjekët e institucioneve spitalore univer-sitare 10 000 lekë;

b) mjekët e spitaleve rajonale 5 000 lekë.”

i) Lidhja nr. 4, e përmendur në pikën 13, të vendimit, zëvendësohet me lidhjen nr. 4, “Nivelet e pagave për mjekët me tituj e grada shkencore”, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

13. Mjekët me tituj e grada shkencore, të cilët janë punonjës efektivë të qendrave spitalore e shërbimeve universitare, si dhe të klinikës stomatologjike, që gëzojnë statusin e qendrave kërkimore-shkencore, trajtohen në pagë sipas lidhjes nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

14. Për çdo fluturim, pilotët dhe teknikët e Njesisë së Transportit Mjekësor me Helikopterë paguhën në masën 1 200 (një mijë e dyqind) lekë.

15. Shfuqizuar.

15/1. Shfuqizuar.

16. Pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve që bëjnë pjesë në fushën e veprimit të këtij vendimi,

përcaktohen në bazë të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore.

17. Të gjitha dispozitat që bien në kundërshtim me këtë vendim shfuqizohen.

17.1. Funksionarët dhe nëpunësit, që përfshihen në fushën e veprimtimit të këtij vendimi, nuk përfitojnë shtesa të tjera mbi pagë, të përcaktuara me vendime të tjera të Këshillit të Ministrave.

18. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit për rritjen e pagave për vitin 2011.

19. Trajnimi i personelit mjekësor, personelit paramedikal dhe publikut të gjerë kryhet nëpërmjet veprimtarive të trajnimit që organizohen nga vetë Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore ose/dhe në bashkëpunim me Universitetin e Mjekësisë apo qendrat spitalore.

Në rastet kur punonjësit e personelit mjekësor (me arsim të lartë) të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore marrin pjesë në veprimtaritë e trajnimit (si për personelin mjekësor ashtu edhe për personelin paramedikal dhe publikun e gjerë), të cilat organizohen nga vetë qendra, për çdo orë mësimi 60-minutëshe përfitojnë trajtim me pagesë, si më poshtë vijon:

a) Trajnerët me më pak se 10 (dhjetë) vite punë në profesion përfitojnë një pagesë 750 (shtatëqind e pesëdhjetë) lekë për orë;

b) Trajnerët me më shumë se 10 vite punë në profesion përfitojnë një pagesë 1 500 (një mijë e pesëqind) lekë për orë.

Trajnerët të cilët janë punonjës të personelit mjekësor (me arsim të lartë) të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore e përfitojnë këtë pagesë deri në 200 (dyqind) orë në vit.

Në rastet kur trajnerët janë bashkëpunëtorë të jashtëm nga Universiteti i Mjekësisë apo nga qendrat spitalore, pagesa për orë do të jetë e njëjtë me trajnerët e brendshëm të qendrës.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrinë efektet financiare nga data 15 korrik 2011.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

(Ndryshuar me vendimin nr. 1076, datë 24.12.2020)

Lidhja nr. 1 (Kreu 1/AP)

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e administrimit të përgjithshëm nga “specialist” deri në “titullar institucioni” në struktura shëndetësore universitare, në spitalet rajonale, spitalet psikiatrike dhe spitalet bashkiake

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Titullar institucioni në QSU “Nënë Tereza”.	1	2%	0	118.600	25.000
2	Titullar institucioni në: - Spitalin Universitar të Sëmundjeve të Mushkërive “Shefqet Ndroqi” Tiranë; - Spitalin Universitar Obsetrik Gjinekologjik nr 1 dhe nr 2 Tiranë; - Spitalin Universitar të Traumës Tiranë.	1	2%	0	118.600	15.000
3	Titullar institucioni në: - Klinikën Stomatologjike Universitare Tiranë; - Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut. - Zëvendëstitullar institucioni në QSU “Nënë Tereza”.	1	2%	0	110.000	15.000
4	Titullar institucioni në spitalet rajonale. Titullar institucioni në spitalet psikiatrike. Zëvendëstitullar institucioni në: - Spitalin Universitar të Sëmundjeve të Mushkërive “Shefqet Ndroqi” Tiranë; - Spitalin Universitar Obsetrik Gjinekologjik nr 1, nr 2 Tiranë; - Klinikën Stomatologjike Universitare Tiranë; - Spitalin Universitar të Traumës Tiranë; - Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.	1	2%	0	97.000	
5	Titullar institucioni në spitalet bashkiake.	1	2%	0	95.000	
6	Zëvendëstitullar institucioni në spitalet rajonale/psikiatrike/bashkiake.	1	2%	0	82.000	
7	Drejtor drejtorie në QSU “Nënë Tereza”.	1	2%	0	82.000	
8	Përgjegjës sektori biomedikal.	1	2%	0	74.000	
9	Administrator për Polin e administrimit të integruar në QSU “Nënë Tereza”.	1	2%	0	65.000	
10	Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes në spitalet universitare dhe në QKTGJ.	1	2%	0	61.000	
11	Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës në spitalet universitare. Përgjegjës sektori Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.	1	2%	0	59.000	

	Përgjegjës sektori në Klinikën Stomatologjike Universitare.					
12	Përgjegjës sektori në spitalet rajonale dhe psikiatrike.	1	2%	0	49.000	
13	Specialist/inxhinier biomedikal në spitalet universitare dhe në QKTGJ.	1	2%	0	61.000	
14	Përgjegjës sektori në spitalet bashkiake. Specialist/inxhinier biomedikal në spitalet rajonale, psikiatrike dhe bashkiake.	1	2%	0	49.000	
15	Specialist auditi/Specialist në QSU "Nënë Tereza".	1 ose 2 ose 3	2%	0	43.000	
16	Specialist auditi/Specialist në: - spitalet universitare; - Klinikën Stomatologjike Universitare Tiranë; - Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.	1 ose 2 ose 3	2%	0	40.000	
17	Specialist auditi/Specialist në spitalet rajonale dhe psikiatrike.	1 ose 2 ose 3	2%	0	38.000	
18	Specialist në spitalet bashkiake.	1 ose 2 ose 3	2%	0	34.200	

Lidhja nr. 1 (Kreu 1.1)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin mjekësor në strukturat shëndetësore universitare dhe në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Shef Shërbimi infektiv në QSUNT.	1	2%	0	103.600	8000
2	Shef Shërbimi.	1	2%	0	103.600	
3	Shef reparti infektiv në QSUNT.	1	2%	0	90.300	8000
4	Shef reparti/klinike (kirurgji,urgjencë etj) Shef i Qendrës së Gruas. Shef njësie në QSUT.	1	2%	0	90.300	
5	Shef reparti/klinike reanimacioni.	1	2%	0	90.300	1100
6	Shef reparti/klinike psikiatrie.	1	2%	0	90.300	5000
7	Shef i Laboratorit Klinik Biokimik. Shef reparti kimioterapi. Shef laborator. Shef i Qendrës së Diagnozës Molekulare.	1	2%	0	90.300	2200
8	Shef Reparti Rezatimi.	1	2%	0	90.300	4600
9	Shef sektori mjekësor. Shef farmacie.	1	2%	0	82.460	
10	Përgjegjës i Sektorit të Laboratorëve/ Shef i Bankës së Gjakut/Shef i Sektorit të Mbledhjes dhe Përpunimit të Gjakut në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.	1	2%	0	82.460	2500
11	Mjek. Stomatolog. Biolog,kimist,fizikant në preparatori. Mikrobiolog,parazitolog,virolog, mykolog. Përgjegjës qendre DDD. Përgjegjës njësie në QSUNT. Specialist fizikulture (fizioterapi neurologji).	1	2%	0	79.800	
12	Mjek/Biokimist/Biolog në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.	1	2%	0	79.800	1600
13	Mjek infeksionist në QSUNT.	1	2%	0	79.800	8000

14	Mjek kirurg (specialitete kirurgjikale). Mjek onkolog. Mjek fizioterapevt. Mjek obseter gjinekolog. Mjek pneumoftiziatër.	1	2%	0	79.800	1100
15	Mjek radiolog. Toksikolog, alkolog, kimist, në laboratorin toksikologjik. Kimist në laboratorin biokimik. Fizikant në laboratorin biokimik. Biolog në laboratorin biokimik.	1	2%	0	79.800	1600
16	Mjek radiolog , në shërbimin infektiv në QSUNT. Mjek në kabinetin e ekografisë, në Shërbimin Infektiv në QSUNT.	1	2%	0	79.800	8000
17	Mjek kimioterapeut. Mjek hematolog. Mjek infeksionist. Mjek në pranim urgjence. Mjek në njësinë nozokomiale. Mjek laborator. Mjek histopatolog. Mjek në shërbimin e gjakut.	1	2%	0	79.800	2000
18	Mjek në Inspektoriatin Sanitar. Inspektor sanitar. Farmacist.	1	2%	0	79.800	2500
19	Farmacist në Laboratorin Toksikologjik. Mjek në hemodinamikë.	1	2%	0	79.800	2800
20	Mjek anatomopatolog. Mjek anesteziist, reanimator. Mjek në pavionin e rezeatimit. Specialist në qendren e diagnozës molekulare. Mjek pediater neonatolog. Fizikant kobalti.	1	2%	0	79.800	3700
21	Mjek, psikologë, punonjës socialë që punojnë në psikiatri.	1	2%	0	79.800	5000

Lidhja nr. 1 (Kreu 1.2)

Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit/punonjësit e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor

I. Në drejtorinë qendrore dhe në drejtoritë rajonale

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Drejtor i Përgjithshëm.	1	2%	0	118.100	
2	Zëvendësdyrëtor i përgjithshëm.	1	2%	0	106.000	
3	Dyrektor drejtorie në drejtorinë qendrore.			0	100.000	
4	Dyrektor i drejtorisë rajonale.	1	2%	0	104.000	
5	Përgjegjës sektori në drejtorinë qendrore. Dyrektor drejtorie në drejtoritë rajonale.	1	2%	0	80.700	
6	Përgjegjës sektori në drejtoritë rajonale.	1	2%	0	61.000	
7	Specialist (niveli i parë).	1 ose 2 ose 3	2%	0	49.000	
8	Specialist (niveli i dytë).	1 ose 2 ose 3	2%	0	38.000	

II. Në njësitë vendore të kujdesit shëndetësor

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1.	Titullar i njërive vendore të kujdesit shëndetësor me qendër në qarqe.	1	2%	0	100.000	
2.	Titullar i njërive vendore të kujdesit shëndetësor me qendër në bashki.	1	2%	0	95.000	
3	Shef shërbimi.	1	2%	0	93.000	
4.	Përgjegjës sektori.	1	2%	0	46.000	

5.	Përgjegjës i shërbimeve të shëndetit mendor.	1	2%	0	72.800	5.000
6.	Mjek/specialist në shërbimet e shëndetit publik.	1	2%	0	64.400	7.000
7.	Mjek/Stomatolog/Farmacist/Inxhinier/Specialist në sektorin e shërbimit parësor.	1	2%	0	64.400	
8.	Mjek/Psikolog/Punonjës social që punojnë në shërbimet e shëndetit mendor.	1	2%	0	64.400	5.000
9.	Specialist.	1 ose 2 ose 3	2%	0	38.200	
10.	Kryeinfërmjer/Kryevaksinator.	1	2%	0	53.200	
11.	Teknik specialitetesh shëndetësore.	1 ose 2 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	2%	0	47.000	1.100
12.	Infërmjer/Terapist në shërbimet e shëndetit mendor.	1 ose 2 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	2%	0	47.000	5.000
13.	Infërmjer.	1 ose 2 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	2%	0	47.000	

Lidhja nr. 1 (Kreu 1.3)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin mjekësor në Qendrën Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1.	Drejtor i Përgjithshëm.	1	2%	0	105.000	
2.	Zëvendësdrejtor i përgjithshëm.	1	2%	0	85.000	
3.	Shef shërbimi.	1	2%	0	82.000	
4.	Përgjegjës sektori.	1	2%	0	46.000	
5.	Mjek. Specialist pediatër neuropediatër. Psikiatër për fëmijë dhe adoleshentë.	1	2%	0	67.000	5.000
6.	Specialist psikolog, punonjës social/terapist/fizioterapist/Logopedist/Pedagogji e specializuar.	1 ose 2 ose 3	2%	0	64.400	5000
7.	Specialist promovimi.	1 ose 2 ose 3	2%	0	36.000	
8.	Specialist.	1 ose 2 ose 3	2%	0	34.200	

Lidhja nr. 1 (Kreu 1.4)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin mjekësor në spitalet psikiatrike, rajonale dhe bashkiake

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Shef Shërbimi në Anatomopatologji.	1	2%	0	90.300	3500
2	Shef shërbimi.	1	2%	0	82.000	
3	Shef Shërbimi Reanimacioni. Shef Shërbimi Infektiv. Shef Shërbimi Obsetrik Gjinekologjik. Shef Shërbimi Kirurgji. Shef Shërbimi Ortopedi.	1	2%	0	82.000	1100
4	Shef Shërbimi në imazheri. Shef Shërbimi Neuropsikiatri.	1	2%	0	82.000	1600
5	Shef Shërbimi Psikiatri.	1	2%	0	82.000	5000
6	Shef reparti/klinike. Përgjegjës/shef kabineti. Përgjegjës/shef laborator /Poliklinike/fizioterapi.	1	2%	0	64.400	
7	Shef i Bankës së Gjakut. Shef Reparti Imazheri. Shef Reparti. Pneumoftiziatri.	1	2%	0	64.400	1100
8	Shef reparti/klinike Psikatri.	1	2%	0	64.400	5000
9	Përgjegjës Laboratori Klinik/Biokimik/Bakterologjik.	1	2%	0	64.400	2500
10	Përgjegjës/Shef reparti Anatomopatologji.	1	2%	0	64.400	3700
11	Mjek. Stomatolog. Kimist.	1	2%	0	64.400	
12	Mjek infeksionist. Mjek urgjence. Mjek laborator. Kimist, fizikant laborator.	1	2%	0	64.400	1100
13	Mjek onkolog. Mjek kirurg (specialitete të ndryshme kirurgjikale).	1	2%	0	64.400	1100

	Mjek hematolog, Mjek i barkës në gjakut, Mjek obster ginekolog, Mjek pneumofiziater, Mjek fizioterapist, Mjek radiolog					
14		1	2%	0	64.400	1600
15	Mjek higjienist, Farmacist	1	2%	0	64.400	2500
16	Mjek anemopatolog, Mjek anesteziat farmatol.	1	2%	0	64.400	3700
17	Mjek, psikolog, punonjës socialë që punojnë në Psikiatri.	1	2%	0	64.400	5000

Lidhja nr. 1 (Kreu 1.5)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin mjekësor dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë në Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore

	EMËRTIMI	PAGA MUIJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Drejtor.	1	2%	0	100.000	7.000
2	Zëvendës drejtor.	1	2%	0	85.000	7.000
3	Shef sektori në sektorët për kontrollin e barnave.	1	2%	0	82.000	
4	Shef sektori në sektorët e tjerë	1	2%	0	50.500	
5	Farmacist, Analist, Mjek, Inxhinier për pajisjet mjekësore	1	2%	0	75.000	4000
6	Farmacist Inspektor për Kontrollin Farmaceutik.	1	2%	0	75.000	5000
7	Specialist.	1 ose 2 ose 3	2%	0	34.200	

Lidhja nr. 1 (Kreu 1.6)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin mjekësor dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë në Qendrën e Shërbimeve Mjekësore

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Drejtor	1	2%	0	74.000	
2	Shef sektori	1	2%	0	55.000	
3	Mjek.Stomatolog.	1	2%	0	64.400	
4	Specialist.	1 ose 2 ose 3	2%	0	42.000	

Lidhja nr. 1 (Kreu 1.7)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin mjekësor dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë në Qendrën e Inxhinierisë Biomjekësore

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa per vjetërsi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa per pozicion (SHP)	Shtesa per kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Drejtor.	1	2%	0	85.000	
2	Përgjegjës i zyrës teknike. Përgjegjës reparti.	1	2%	0	61.000	
3	Shef sektori.	1	2%	0	55.000	
4	Inxhinier biomedikal.	1	2%	0	49.000	
5	Specialist.	1 ose 2 ose 3	2%	0	34.200	

Lidhja nr. 1 (Kreu 1.8)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin mjekësor dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë në Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Drejtor i përgjithshëm.	1	2%	0	118.600	
2	Zëvendës drejtor i Përgjithshëm	1	2%	0	100.900	
3	Drejtor drejtorie	1	2%	0	81.800	
4	Përgjegjës sektori	1	2%	0	71.700	
5	Specialist (mjek)	1	2%	0	79.800	2000
6	Specialist.	1 ose 2 ose 3	2%	0	50.500	

Lidhja nr. 1 (Kreu 1.9)

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit me arsim të lartë në Qendrën Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore dhe Qendrë Kombëtare të Edukimit në Vazhdim.

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Drejtor.	1	2%	0	100.900	
2	Shef sektori.	1	2%	0	62.700	
3	Specialist për akreditimin. Specialist.	1 ose 2 ose 3	2%	0	50.500	

Lidhja nr. 1 (Kreu 1.10)

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Njësisë së Helikopterëve të Transportit Mjekësor të ministritë përgjegjëse për shëndetësinë, në strukturat e ministritë së Mbrojtjes

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Kryepilot	1	2%	0	81.800	8000
2	Pilot	1	2%	0	78.100	8000
3	Teknik Helikopterit Futurues	1	2%	0	74.800	

Lidhja nr.2 (Kreu 2.1)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin teknik të shkencave mjekësore në strukturat shëndetësore universitare dhe personelin teknik të shkencave mjekësore, civilë, në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Kryeinfurmjer Shërbimi Psikiatrik		2%	0	56.000	6000
2	Kryeinfurmjer shërbimi në shërbimin infektiv në QSUNT. Kryeinfurmjer/Kryemami i Përgjithshëm		2%	0	56.000	8000
3	Kryelaborant në Shërbimin e Anatomisë Patologjike. Kryeinfurmjer Shërbimi i Terapisë Intensive. Kryeinfurmjer Shërbimi Onkologjik. Kryelaborant Rrezatim Kobalti. Kryelaborant në Histopatologji. Kryeinfurmjer të Repartit të Rrezatimit.		2%	0	56.000	3400
4	Kryeinfurmjer Reparti/Njësi Psikiatrik.		2%	0	56.000	5000
5	Kryeinfurmjer Reparti në Shërbimin Infektiv në QSUNT.		2%	0	56.000	8000
6	Kryeinfurmjer shërbimi Neurokirurgji. Kryeinfurmjer/kryemami reparti i Terapisë Intensive/Stroke dhe Post stroke. Kryeinfurmjer në Hemodinamikë.		2%	0	56.000	2600
7	Kryeinfurmjer kimioterapi. Kryelaborant klinik biokimik. Kryeinfurmjer në urgjencën e Sëmundjeve të Brendshme. Kryeinfurmejer/mami salle. Kryeinfurmjer/mami e dhomës së zgjimit. Infurmjer në hemodinamikë. Kryelaborant imunolog,bakteriolog.		2%	0	56.000	1800
8	Kryeinfurmjer shërbimi (kirurgji, neurologji, djegie plastike, kardiokirurgji, maksilofacial, infektiv, pediatrik infektive, obsetrik). Kryeinfurmjer/kryemami në Repartin e Kirurgjisë. Kryemami turni në Kirurgji/në Obsetrikë. Kryeinfurmjer reparti Infektiv. Kryeinfurmjer reparti (fizioterapi, urologji, urgjencës së neurologjisë, neurokirurgji, onkologji). Kryeinfurmjer/kryemami salle operacioni.		2%	0	56.000	1100
9	Kryeinfurmjer shërbimi. Kryelaborant shërbimi. Kryemami shërbimi. Kryeinfurmjer/Kryelaborant në QKTGJ		2%	0	56.000	
10	Infurmjer/laborant në psikiatri.		2%	0	53.200	5000

11	Laborant histopatolog.		2%	0	53.200	3400
12	Infermjer/Mami reanimacioni, neonatologji. Infermjer ne dhomën e zgjimit.		2%	0	53.200	2650
13	Infermjer në kimioterapi.		2%	0	53.200	1800
14	Kryelaborant imazherie.		2%	0	53.200	1500
15	Specialist i sektorit të kujdesjeve infirmjerore.		2%	0	53.200	1100
16	Kryeinfermjer në repartin e alergologjisë.		2%	0	53.200	
17	Laborant radiolog në onkologji.		2%	0	47.000	3700
18	Laborant rezatim kobalti.		2%	0	47.000	3400
19	Laborant në mjeksinë bërthamore.		2%	0	47.000	2650
20	Infermjer në njësinë e inspektoriatit sanitar dhe infeksioneve nazokomiale. Infermjer/mami në sallën e operacionit.		2%	0	47.000	2100
21	Kryeinfermjer reparti pranim urgjence. Laborant klinik biokimik. Infermjer në punktin e gjakut. Infermjer në hematologji. Infermjer në onkologji. Infermjere endoskopie. Infermjer/laborant bakterilog, imunolog.		2%	0	47.000	1800
22	Infermjer reparti radiologjik/angio CT. Teknik imazherie dhe angio CT. Laborant radiolog. Kryeinfermjer (pranim urgjence, djegie plastike, kirurgji). Kryemami në qendrën e gruas.		2%	0	47.000	1500
23	Infermjer/mami (kirurgji, maksilofaciale, neurokirurgji, kardiokirurgji, djegie plastike, obsetrike, gjinekologji/patologji barre/neonatologji). Infermjer salle. Infermjer/Laborant në QKTGJ.		2%	0	47.000	1100
24	Kryeinfermjer neonatologji. Kryemami pranimi. Kryeinfermjer në kabinetin e dializës. Kryemami/Kryeinfermjer reparti/klinik/turni. Kryeinfermjer konsultash në sëmundjet e brendshme. Kryelaborant bakterolog,imunolog,ortopedi stomatologjike).		2%	0	47.000	
25	Infermjer pavioni rezatimi.		2%	0	45.000	3310
26	Infermjer në shërbimin infektiv në QSUNT.		2%	0	45.000	8000
27	Infermjer pranim urgjence, (njësia e kordinimit të urgjencës).		2%	0	45.000	1800
28	Infermjer në hemodializë.		2%	0	45.000	1500
29	Infermjer fizioterapi.		2%	0	45.000	1100
30	Laborant (ezhe, ortopedi, stomatologji). Infermjer. Mami.Logopedi. Infermjer çerdhe për personelin. Kujdestar. Prozeaktor.		2%	0	45.000	
31	Kujdestar në psikiatri.		2%	0	39.550	5000

Tabela nr. 2 (Krona 2.2)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin teknik të shërbeseve mjekësore në Qendrat Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijë

	ENDEFCODE	Paga e Bazë GCD	Shërbim për Niveli CSN1	Shërbim për Niveli CSN2	Paga e Bazë GCD	Shërbim për Niveli CSN1
I	Infancia	1	2	3	4	5
			200	0	45.000	0

Lidhja nr. 2 (Kreu 2.3)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin teknik të shkencave mjekësore në spitalet psikiatrike, rajonale e bashkiake dhe personelin teknik të shkencave mjekësore, civilë, në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura të sistemit të ministrisë së Mbrojtjes

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Kryeinfermier i përgjithshëm në spitalet psikiatrike.		2%	0	56.000	6000
2	Kryeinfermier reparti në spitale psikiatrike.		2%	0	56.000	5000
3	Kryeinfermier i përgjithshëm.		2%	0	56.000	1100
4	Laborant në Anatominë Patologjike		2%	0	53.200	3400
5	Kryelaborant në laboratorin klinik biokimik, bakterologjik. Kryeinfermier (kirurgji , reanimacion, sallë operacioni, obsetrikë gjinekologji).		2%	0	53.200	1100
6	Kryeinfermier.		2%	0	53.200	
7	Infermier në psikiatri Laborant në psikiatri		2%	0	47.000	5000
8	Infermier reanimacioni. Ndihmës anesteziat. Ndihmës farmacist. Laborant radiologjie. Infermier në imazheri. Infermier salle. Infermier në hemodializë.		2%	0	45.000	1500
9	Kryeinfermier në poliklinikën e spitalit. Infermier (fizioterapi, ergoterapi, logoterapi, neuropsikiatri, infektiv, dispanceri të sëmundjeve ngjitëse, kirurgji, ortopedi, obsetrikë, gjinekologji,pneumoftiziatri, onkologji,dispanceri). Infermier në repartin e lindjes. Infermier/laborant në bankën e gjakut, hematologji. Përgjegjës tumi.		2%	0	45.000	1100
10	Kryeinfermier në Qendrën e Sterilizimit. Infermier pranim urgjence. Laborant klinik biokimik /bakteriologjik.		2%	0	45.000	600
11	Infermier.		2%	0	45.000	
12	Kujdestar në Psikiatri.		2%	0	39.550	5000
13	Kujdestar në Pediatri. Ndihmës infermier.		2%	0	39.550	

Lidhja nr. 2 (Kreu 2.4)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin teknik të shkencave mjekësore në Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Laborant.		2%	0	54.000	

Lidhja nr. 2 (Kreu 2.5)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin teknik të shkencave mjekësore në Qendrën e Shërbimeve Mjekësore

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Kryeinfiermjer.		2%	0	56.000	
2	Infermjer. Ndihmës stomatologë.		2%	0	45.000	

Lidhja nr. 2 (Kreu 2.6)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin teknik të shkencave mjekësore në Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Kryeinfiermjer urgjence.		2%	0	56.000	2000
2	Infermier urgjence.		2%	0	53.200	2000

Lidhja nr. 2 (Kreu 2.7)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin në Njësitë e Helikopterëve të Transportit Mjekësor të ministritë përgjegjëse për shëndetësinë, në strukturat e ministritë së Mbrojtjes

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Teknik i përgjithshëm. Teknik elektrik.		2%	0	39.000	

Lidhja nr. 3

Vlera e pagës së grupit sipas nivelit arsimor

GRUPI	LLOJI I DIPLOMËS	PAGA NË LEKË
1	Master i Shkencave. Master i Arteve. Master Profesional të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike. Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.	14000
2	Master Profesional. Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.	11000
3	Bachelor. Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.	10000
4	Diplomë e shkollës së mesme për personelin teknik të shkencave mjekësore, Lidhja nr. 2	8000
5	Dëftesë lirim (arsimi 8/9 vjeçar) dhe kurse infermierie, për personelin teknik të shkencave mjekësore, Lidhja nr. 2	6000

Lidhja nr. 4

Struktura dhe nivelet e pagave për mjetet me tituj dhe gradë shkencore

KUALIFIKIMET/GRADA/TEITULLI	PAGA ÇEKË/NUJAD	Shënim
Shëf. i institutit nga kategoria "Profesor"	123.500	31.400
Shëf. i institutit nga kategoria "Asistent"	100.000	30.500
Profesor	121.000	31.300
Asistent i asistuar	105.500	30.100
Asistent	95.500	29.500

Lidhja nr. 5

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e personelit me tituj akademikë, në Institutin e Shëndetit Publik

Nr rendor	Emërtimi	Paga	Shtesë për kushte pune.
1.	Zëvendës titullar institucioni nga kategoria "Profesor"	130.500	10.000
2.	Zëvendës titullar institucioni nga kategoria "Docent"/"Doktor"	123.800	10.000
3.	"Përgjegjës i Njesisë bazë nga kategoria "Profesor"	123.800	10.000
4.	"Përgjegjës i Njesisë bazë nga kategoria Docent/Doktor	106.700	10.000
5.	"Përgjegjës sektori nga kategoria "Profesor"	123.800	10.000
6.	"Përgjegjës sektori nga kategoria "Docent/Doktor	106.700	10.000
7.	Profesor	121.000	10.000
8.	Profesor i Asociuar	105.200	10.000
9.	Docent (Doktor)	95.800	10.000
10.	Docent (Master)	91.800	10.000
11.	Kërkues i parë	90.300	10.000
12.	Kërkues.	73.400	10.000

Lidhja nr. 6

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e tjerë me arsim të lartë në Institutin e Shëndetit Publik

EMËRTIMI		PAGA MUJORE					
		Kate goria	Paga e Grupi t (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kuali fikim (SHK)	Shtesa e pozicioni t (SHP)	Shtesë për kushte pune
1	2	3	4	5	6	7	8
1	Titullar insitucioni	II-a	1	2%	0	118.100	10.000
2	Zëvendëstitullar ekonomik	III-a	1	2%	0	80.800	
3	Drejtor i Drejtorisë së Mbrojtjes nga Rrezatimet. Drejtor i drejtorisë së shërbimeve mbështetëse	III-a	1	2%	0	80.800	
4	Përgjegjës sektori në njësité e përmbajtjes pa tituj e grada.	III-a/1	1	2%	0	75.000	
5	Përgjegjës sektori mbështetës.	III-b	1	2%	0	61.000	
6	Specialist në njësité e përmbajtjes pa tituj e grada.	III-b	1 ose 2 ose 3	2%	0	61.000	
7	Specialist në sektorët mbështetës.	IV-b	1 ose 2 ose 3	2%	0	38.000	

Lidhja nr. 7

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin teknik të shkencave mjekësore në Institutin e Shëndetit Publik

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
1	Laborant mikrobiologji teknike laborator/infermier në njësinë e epidemiologjisë dhe sëmundjeve infektive.	1	2%	0	45.000	5000
2	Laborant kimist, mikrobiolog, biokimist në njësinë e shëndetit dhe mjedisit dhe të vivariumit.		2%	0	47.000	3700

Lidhja nr. 8

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin mjekësor dhe personelin teknik të shkencave mjekësore në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkatës

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Shef shërbimi.	1	2%	0	82.000	5000
2	Mjek të përgjithshëm. Mjek të specialiteteve të tjera. Stomatolog. Farmacist.	1	2%	0	64.400	4000
3	Kryeinfermier.		2%	0	53.200	5000
4	Infermier.		2%	0	45.000	5000

Lidhja nr. 9

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin mjekësor civil në strukturat e Forcave të Armatosura të shtetit të Ministrisë së Mbrojtjes

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE			
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)
1	Mjek të përgjithshëm. Mjek të specialiteteve të tjera.	1	2%	0	64.400

LIDHJA 2 (KREU 2.8)
STRUKTURA E PAGAVE PËR TEKNIKËT NË NJËSITË E HELIKOPTERËVE TË
TRANSPORTIT MJEKËSOR TË SHËNDETËSISË, NË STRUKTURAT E MINISTRISË
SË MBROJTJES

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Teknik i përgjithshëm. Teknik elektrik		2%	0	35.200		Nga...deri ... lekë